



|                                                           |                               |                              |                               |
|-----------------------------------------------------------|-------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Prenje/Prudato<br>Received/Delivery | 25-11-2022                    | 2                            | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njësia<br>Organ /Jednica<br>Org /Unit              | Dr Prot<br>Bj Prot<br>Prot No | Shtesa<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKINSHKRI 7427/2022                                       |                               |                              | 115                           |



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr. 909/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar Malore Gashi-Bajraktari, dhe Arben Mehmeti, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kane shqyrtuar ankesën me numër A. Nr. 909/2022, të datës 14.10.2022, të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi rruga, kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit e Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A. Nr. 909/2022, të datës 14.10.2022, e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, më datë 07.04.2022 ka shpallur konkursin për pozitën Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikim të Pronës. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili ka marre pjese ne të gjitha fazat e rekrutimit, mirëpo sipas njoftimit të datës 01.09.2022 nuk është përfshirë nga Komisioni Përzgjedhës në listën rekomanduese për pozitën, „Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive” të Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikim të Pronës.

Ankuesi i pakënaqur me mos përzgjedhjen në listën rekomanduese për pozitën „Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive” të Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikim të Pronës me datë 14.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6174/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 20.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Sekretaria Koordinuese e Qeverisë së Kosovës, ndërsa me datë 24.10.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankese nga Zyra e Kryeministrit se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedure.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e anasve, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike: Ankesën me nr. protokollin 6174/22 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesi Konkursin e datës 07.04.2022 për pozitën Drejtor Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikim të Pronës; Njoftim për kandidatin i datës 26.08.2022; Kriteret dhe informatat e përgjithshme lidhur me procedurën e konkurrimit në Konkursin për Drejtor Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës; Njoftimin të datës 26.08.2022 nga për kandidatin Njoftimin për intervistë të datës 30.08.2022 nga për kandidatin Shkresë drejtuar Kryeministrit nga parashtruesi i ankesës z.Arben Pasjaqa të datës 26.09.2022; Ankesën elektronikë të datës 13.10.2022; Përgjigje në kërkesën e KPMSHCK me nr. Protokollin 6407/2022 të datës 24.10.2022 nga Listën e kandidatëve që kanë aplikuar për Drejtor të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikim të Pronës; Listën e Aplikantëve që kanë aplikuar për Zv.Drejtor të AKVP; Vendimin për emërimin e Komisionit Përzgjedhës për zgjedhjen e Zëvendësdrejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me nr. Protokollin 256 të datës 10.02.2022 të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit; Vendimin për emërimin e Komisionit Përzgjedhës për zgjedhjen e Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës me nr. Protokollin 1928 të datës 17.08.2022 të lëshuar nga Zyra e Kryeministrit; Listën e kandidatëve që janë përzgjedhur për intervistë me gojë për Zv/Drejtor dhe Drejtor të Sekretarisë të AKVP; Listën Rekomanduese për Zëvendësdrejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 01.09.2022; Listën Rekomanduese për emërimin e Komisionit Përzgjedhës për zgjedhjen e Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 01.09.2022; Aplikacioni për punësim me Cv-në e kandidatit, së bashku me dëshminë dhe mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Letër Motivimi të kandidatit Dëshmi e Punës të lëshuar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 29.08.2022 të Letër Rekomandimi të kandidatit Dëshminë e Punës të lëshuar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 26.08.2022 të Letër Rekomandimi të kandidatit Dëshminë e Punës të lëshuar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 15.04.2022 të Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik me nr.2866 të datës 10.10.2011 të Certifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me nr.7112/2022 të datës 08.04.2022 të Pasqyrën e Llogarisë së Trustit të Kopjen e Letërnjoftimit të Vendimin për emërimin e UD Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të lëshuar nga Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) të datës 10.02.2022 të Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit e lëshuar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 11.01.2020 të Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit e

UBI  
11/11/2022

KO  
STRUKTUR  
2005

lëshuar nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës të datës 07.08.2018 të Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës të datës 03.08.2015 të Akt Emërimi i lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës të datës 11.01.2012 të Kontratën e Punësimit nga Agjencia Kosovare e Pronës 26.11.2015 të Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit e lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për Arben Pasjaqa të datës 22.12.2014; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit i lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për të datës 01.07.2014; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit e lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për të datës 07.03.2014; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit e lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për të datës 06.06.2013; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit e lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për të datës 25.01.2013; Përshkrimi i Punës nga Agjencia Kosovare e Pronës për Akt Emërim të lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për të datës 11.01.2012; Kontrate e Punës e lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për të datës 11.01.2012; Ndryshimin dhe Plotësimin e Kontratës së punës e lëshuar nga Agjencia Kosovare e Pronës për të datës 16.08.2011; Kontratën e Marrëdhënies së Punës në mes Agjencisë Kosovare të Pronës dhe me nr.336/AKP/2011 të datës 17.08.2011; Kontratën e Marrëdhënies së Punës në mes të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe me nr.336/AKP/2011 të datës 22.12.2010; Kontratën e Marrëdhënies së Punës në mes të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe me nr.336/AKP/2010 të datës 12.01.2010; Njoftimin për kandidatin të datës 30.08.2022 nga Aplikacioni për punësim me Cv-në e kandidatit së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Aplikacioni për punësim me Cv-në e kandidatit së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës;; Aplikacioni për punësim me Cv-në e kandidatit, Cv-në e kandidatit së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Kërkesën për Punësim të Kërkesën për Punësim të së bashku me dëshminë dhe mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës; Cv-në e kandidatit së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Cv-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Cv-në e kandidatit së bashku me përgatitjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Cv-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; CV-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; CV-ne e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; CV-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; CV-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të punës; CV-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të punës; CV-në e kandidatit së bashku me përgaditjet profesionale dhe atë të përvojës së punës; CV-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të punës; CV-në e kandidatit së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të punës; Kërkese për përgjigje në Ankese me numër protokolli 6319/2022 të datës 20.10.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi SEPSE:

Ligji Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës gjegjësisht neni 4 paragrafi 1 ka përcaktuar se: *“Agjencia është Agjenci e pavarur e themeluar sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me mandat të përkohshëm”*, ndërsa organizimi i kësaj agjencie është përcaktuar me nenin 5, ku përcaktohet se: *“1. Agjencia përbëhet nga: 1.1. Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë; 1.2. Sekretaria Ekzekutive; 1.3. Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP); 1.4. Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona (KVVP)”*, ndërlidhur me këtë neni 7 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, përcakton se: *“Sekretaria ka Drejtorin dhe Zëvendësdrejtorin. Drejtori dhe Zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri me mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje juridike-administrative, i'u është referuar neni 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, i cili përcakton themelimin e agjencive të pavarura: *“1. Agjencitë e pavarura themelohen me ligj në bazë të nenit 142 të Kushtetutës”*, ndërsa udhëheqja dhe organizimi i agjencisë së pavarur, janë përcaktuar me nenin 41 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji i cili ka përcaktuar se: *“1. Agjencia e pavarur drejtohet nga titullari apo nga një organ drejtues kolegjal në pajtim me ligjin e themelimit. 2. Titullari apo organi drejtues kolegjal i agjencisë së pavarur mbështetet nga administrata e institucionit përkatës”*, ndërsa Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikimin të Pronës është paraparë më shtojcën 1: në numrin rendor 5 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura.

Referuar dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 3 lidhur me përjashtimet nga fusha e zbatimit të Ligjit, ku përcaktohet se: *“1. Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publikë; 1.2. funksionarët publikë me status të veçantë. 2. Funksionarë publikë, në kuptimin e nënparagrafit 1.1 të këtij neni, janë: 2.1. të zgjedhurit; 2.2. anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; 2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjinale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura. 3. Funksionarë publikë me status të veçantë, në kuptimin e nënparagrafit 1.2 të këtij neni janë: 3.1. gjyqtarët dhe prokurorët; 3.2. personeli komandues dhe ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës apo të organizatës tjetër pasardhëse; 3.3. zyrtarët policor të Kosovës dhe inspektorati policor i Kosovës; 3.4. zyrtarët doganor të Kosovës; 3.5. personeli drejtues dhe punonjësit e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. 3.6. drejtori apo anëtarët e organit drejtues kolegjal të agjencive rregullatorë”*, si rezultat i kësaj meqenëse me nenin 7 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, *“1. Drejtori dhe Zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri me mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje”*, atëherë në kuptim të kësaj dispozite dhe neni 3 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, këto pozita nuk hyjnë në kuadër të pozitave të zyrtarëve të shërbimit civil, ndërsa në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh faktin se pozita ku ka aplikuar ankuesi nuk është pozitë e nëpunësit civil, Kolegji për

Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.909/2022 e datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesi.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda Nr. A. Nr. 909/2022**

Rushit KALTAZI  
  
Procesmbajtës

  
Eshref SHABANI  
  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Divizionit për Mbështetje të Trupave Qeveritare në ZKM;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.